



POLITIKA 3

**Klosi: LSI po identifikohet me politikën e vjetër dhe Fatimenë e Ndroqit**

RAPORTI 11

**Ftesë vetëm për Kroacinë**  
Nga Mark John "Reuters"

DOSSIER 16

**Grattaceli (qiuellgjerrësi) i parë në Tiranë**  
Nga dr. Orhan Sakiqi



KULTURA 20-21  
**Humanizmi si epigëndër e poezisë**  
Nga Gjekë Marinaj

# TEMA

E MËRKURË 5 MARS 2008  
WWW.TEMA.AL

30 LEKË

Gazetë e përditshme  
Numër 2296 | Viti VII



REFORMA

## Pensionet, si do të funksionojë sistemi privat

Zëvendësministri i Financave, Sherefedin Shehu: "Ristrukturimi i sistemit aktual synon ndarjen e pensioneve nga ndihmat ekonomike, me qëllim që të kemi një sistem pensionesh, ku përfitimet të jenë të bazuara nga kontributet"

"RISTRUKTURI I SISTEMIT aktual synon ndarjen e pensioneve nga ndihmat ekonomike, me qëllim që të kemi një sistem pensionesh ku përfitimet të jenë të bazuara nga kontributet". Kështu ka deklaruar dje zëvendësministri i Financave, Sherefedin Shehu, për mediat, duke komentuar edhe nismën e publikuar një ditë më parë nga Ministria e Financave dhe Banka Botërore, lidhur me të ardhmen e skemës së pensioneve. "Dua të siguroj të gjithë qytetarët se qeveria nuk do të prekë përfitimet aktuale, por do të përforcojë ato që jepen në të ardhmen", - tha Shehu. Ai theksoi se, kalimi në sistemin trikolonësh do të kërkojë disa vite për të hyrë në zbatim dhe se debate synon të përfshitë të gjithë krahët politikë si dhe specialistët e kësaj fushe, me qëllim marrjen

e një konsensusi sa më të gjerë. "Është e rëndësishme që në këtë debat të marrin pjesë të gjithë dhe të nisim të gjejmë rrugëzgjdhje me një pranim sa më të gjerë politik dhe social", - tha numri dy i Financave, Shehu.

### Tri shtyllat

Sipas Shehut, flitet për një sistem 3-kolonësh, i cili ekziston në një shumicë vendesh, por, në fakt, sistemi 3-kolonësh, përsëri është një sistem i ndarë në dy komponentë që quhet komponenti i detyrueshëm, ose shtetëror dhe komponenti privat. "Komponenti i detyrueshëm në praktikën e sigurimeve shoqërore ndahet në dy kolona, që quhen e para dhe e dyta. E para është një sistem që përdoret nga shumica e vendeve dhe është sistemi që ne kemi sot, por që është një sistem i përzier me elementë të politikave sociale. Tashmë, ne kemi filluar të flasim për kolonën e dytë, e cila do të zbatohet pas një diskutimi dhe mund të fillojë pas 3 apo 5 vjetësh", - u shpreh Shehu, duke shpjeguar se, bëhet fjalë për një reformë që e ndan kolonën e parë në dy menaxherë - një menaxher shtetëror dhe një privat.

"Pjesa e kontributeve të detyrueshme apo e kontributeve dhe përfitimeve nga sistemi ekzistues që menaxhohet nga insitucione private... ■ 8

QSUT, PRISHEN APARATURAT E ANALIZAVE

23

EDITORIAL

## Për të shpejtuar përparimin e Ballkanit Perëndimor drejt BE

Olli Rehn  
Komisioneri evropian për Zgjerimin

KËTË VIT, popujt në Ballkanin Perëndimor përballen me një zgjedhje të qartë: ose rajoni i tyre do të zgjidhë përfundimisht problemet e tij nga luftërat e viteve '90, ose do të kthehet prapa te mungesa e stabilitetit dhe te nacionalizmat ekstreme. Opsioni i parë do t'i çojë ata drejt stabilitetit, përparimit dhe integritimit evropian. Në fakt, të gjitha vendet mund të ecin shumë shpejt përpara në rrugën drejt Evropës. Nga fundi i këtij viti, shpresoj që ato të gjithë të bëjnë një hap përpara.

Kroacia po i afrohet fazës vendimtare të negociatave të anëtarësimit. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë do të mund të demonstrojë së shpejti gatishmërinë e saj për të filluar negociatat për anëtarësim, nëse do të vazhdojë të ruajë vullnet të mjaftueshëm politik dhe dialog ndërpartiak për të ecur drejt reformave me seriozitet. Shqipëria dhe Mali i Zi kanë nevojë të dëshmojnë me rezultate zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian. Unë shpresoj që Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia do ta kalojnë pragun drejt kandidimit për anëtarësim, duke... ■ 10



Aparaturat që mundësojnë kryerjen e analizave kanë dalë jashtë funksionimit, shkak është prishja e destilatorit që shërben për destilimin e ujit. Për këtë arsye, drejtorja e QSUT-së ka dhënë urdhrë që në spital të realizohen vetëm analizat më urgjente, pasi për momentin po punohet me një aparat urë, e cila ofron vetëm një kapacitet të vogël analizash

Komentoni në webfaqen tonë [www.tema.al](http://www.tema.al)

POLITIKA ■ Topi: Të merren në konsideratë të gjitha partitë për reformën ■ 2

KRONIKA ■ Mister zhdukja e helikopterit, s'gjenet asnjë gjurmë ■ 7

EKONOMIA ■ Bojaxhi: Do të kërkojmë rritje të dytë të çmimit të energjisë ■ 15

VËZHGIM ■ Pista e skive në Dardhë, shuhet premtimi ■ 18

Ish të dënuarit e regjimit komunist

0	0
4	4
2	2
5	5
6	0
9	6
0	9
3	5

POSTA SHQIPTARE

Aplikime për Ministrinë e Drejtësisë

Pensione private  
Depozitë me Sigurim

UNIQA

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA



Principi me të cilin shkruan Dibrani, ka diçka të zbatueshme nga filozofia e piktorit të madh Degas, i cili thoshte (citim i lirshëm i imi) se nuk piktoronte të shfaqte para nesh gjërat që shihnte, por gjërat që do na bënin ne të shohim ato që ai kishte parë aq thellësisht

## Humanizmi si epiqendër e poezisë

Shënime mbi librin më të ri poetik të Shefqet Dibranit “Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër”

**Nga Gjekë Marinaj**

**POETI QË ËSHTË NJERI** është njeri edhe poet. Shefqet Dibrani me përmbledhjen e tij më të fundit poetike “Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër” të bind se poeti dhe njeriu i vërtet janë një-suar më parë në artin njerëzor e pastaj në atë poetik. Ndjenjat deri në fund fisnike dhe dashuria e lartë për njeriun janë zëri i pastër i tij, zëri që shoqëron instrumentin më human, motivin më njerëzor, sakrificën më të bekuar—poezinë—që ai krijon për vete dhe për ne. Kjo është hera e tretë që shkruaj për librat poetik të Dibranit. Ajo që kam vënë re tek vetja është e çuditshme për mua; sa herë shkruaj për veprat e tij ndjej një përgjegjësi më të lartë profesionale për t’ia trajtuar poezinë me një delikatesë më njerëzore, me një pastërti mendimi më të vetëdijshme, me një interpretim kritik më të filtruar pavarësisht nga shkolla e mendimit me të cilën mund ta gjykoj atë. Vetëm realizimi me sukses i një objekti të tillë nga ana ime, në rolin e kritikut letrar, mund të binte në ekuilibër me përpjekjet që vetë poeti ka bërë gjatë kompozimit të poezisë për të realizuar të njëjtën gjë, poezi e cila duket qartë se është krijuar thellësisht me lexuesin në mendje.

Si plastika ashtu edhe lënda e trajtuar në këtë libër janë reflektime të një pasurie të dukshme letrare, epiqendra e së cilës është humanizmi. Poezia e Dibranit është një poezi elegante, e përmbajtur dhe e shkruar me modesti. Në të vërtetën e saj mund të kapësh pjesë nga natyra, koha dhe njerëzimi. Në të mund të dëgjosh qarjet e të gjallëve dhe rënkimet e të vdekurve, që së bashku të duket sikur të thërrasin, sikur të ftojnë të bëhesh pjesë e realitetit, të ftojnë të ndjesh si fuqinë e Dibranit si poet ashtu edhe fuqinë tonë si lexues.

E tillë është edhe poezia nga ku shkëputëm vargjet që pasojnë. Drama e përshkruar e përshinë lexuesin në një arenë të tillë artistike saqë shtesat e mendimit transformohen në hiperbola. Aty figurat letrare ekzagjerohen me kujdes që nëpërmes krahasimit konceptues fjalët kyçe si zjarri, paqe, revolucionet, varre etj. marrin jetë. Ato janë i-ja e alfabetit të hallevë të një populli, ku pika mbi të mbetet mërgimi:



Shefqet Dibrani

*Zjarret e luftës dogjën njeriun...  
Në kohë paqeje të djegurit i gjejmë në pedestal.*

*Revolucionet rrëzojnë malet, kurse fushat i bëjnë varre (fq. 17)*

Kjo teknikë shprehje, në një pamje pak-a-shumë abstrakte, është një reflektim i tmerreve të natës në përtëtimin e ditëve të popullit kosovar, i cili e luftoi errësirën gjer në pikën e fundit të kapacitetit. Realiteti që pasqyrojnë vargjet këtu është një fenomenin që ta bën zemrën të qajë por sytë t’i mban të tharë, sepse e para përfaqëson kurajën dhe tjetra vizionin.

Fjala vizion në këtë libër ka edhe domethënie të tjera—vizion do thotë edhe pikëpamje. Kjo e shpjegon se pse Dibrani nuk ka cikël të veçantë për luftën e Kosovës. Vendimi i tij si poet në këtë pikë qëndron në faktin e thjeshtë se çdo poezi e librit (duke filluar nga ajo për djalin e tij me rastin e ditëlindjes, për të vazhduar me poezi të për dashurinë, e për të përfunduar me poezitë për Ibrahim Rugovën), në një formë apo një tjetër, e ka Kosovën

dhe luftën e saj të shkrirë në vargje. Lexuesi nuk do e ketë të vështirë ta kapë këtë vlerë të poezisë së Dibranit. “Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër” të fton të bëhesh pjesë e një botë sa trishtuese aq edhe dramatike, të fton të bëhesh pjesë e mrekullisë të poezisë kur ajo i “ngrenë” nga varret të gjitha frymëmarrjet e të ndjerëve që ranë për Kosovën. Në kontrast me shumë poezi që lexojmë me këtë subjekt, të cilat të lënë shijen e hidhur sikur poeti sillet i përgjumur rreth trunjeve të pamundura, pa shkrirë asgjë nga esenca e vështirësisë, pa zbutur asgjë nga kryeneçësia me të cilën e ruan dhe e zhvillon atë. Mesazhi inkurajues i saj sikur të mbështjellë në një tisi të butë qetësie që të jep një “dorë” për kalimin mbi telashet e jetës, shpesh duke të shkëputë nga vetja, për të lëshuar diku në besimin e njeriut të mirë:

“

Ëndërr e njëjtë,  
tokë tjetër” të  
fton të bëhesh  
pjesë e një botë  
sa trishtuese aq  
edhe dramatike,  
të fton të bëhesh  
pjesë e mrekullisë  
të poezisë kur ajo i  
“ngrenë” nga varret  
të gjitha frymëmarr-  
jet e të ndjerëve që  
ranë për Kosovën

*Ma zgjate mirësinë kur varka ime  
fundosej*

*atëherë kur më përplasën ligësitë  
kur njeriu m’i përmbyti dashuritë  
dhe ëndrrat e besimit për njeriun e  
mirë (fq. 25)*

Dhe kjo nuk ndodh vetëm në një apo dy poezi të librit. Në përgjithësi “Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër” celebron jetën e njeriut të mirë, duke observuar me sy të hapur dhe mendje aktive brigjet politike dhe shoqërore të humanizmit. Ai është i gatshëm t’i tregoi botës letrare se Shefqet Dibrani nuk është i vetmi poet në këtë botë, se poezia nuk i del vetëm nga shtrydhja e mendjes por edhe nga gjerësia e shpirtit. Ai u kushton poezi miqve dhe shokëve, duke ua dedikuar atyre me emër ato, me mirënjohje të çiltër për rolin e tyre jo vetëm në shoqëri, por edhe në jetën e tij personale. Me këtë ai vetëm e lartëson veten si njeri dhe si poet. Bile unë do të shkoja aq larg sa të them se me zemërbardhësinë dhe dashamirësinë që tregon në varg në të mirë të kole-

gëve të tij, Dibrani ngjitet mbi të gjithë ne poetët e brezit të tij. Kjo ndodh sepse ai vet në shpirt është zbulues i atyre që sipas tij shkëlqejnë, dhe jo ndryshk mbi ta, sepse vetëm:

*Ndryshku e mbulon metalin  
Nga që e urren shkëlqimin (fq. 75).*

Vlen për tu përmendur se poezi të tilla si “Ndryshku”, pjesë e së cilës janë dy vargjet që sapo cituam, i shërbejnë si strukturës shpirtërore ashtu edhe asaj artistike të librit. Tek “Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër” gjuha e poezive është elegante, e mençur. Ajo shfaq në vetvete një strukturë që e shtyn në substancën e pasur dhe të pasionuar të vargut drejt një kompleksiteti më domethënës artistik. Kompleksiteti i gjuhës poetike të Dibranit nuk tenton të anojë nga artificialiteti, më këtë ai demonstroi se qëllimi i lartë i poezisë së tij është ngritja në një platformë më të dukshme të atyre aspekteve dhe ndodhive jetësore që janë të vështira në arritje, thellësisht dhimbse dhe shqetësuese në kuptimin themelor të poetikës. Dibrani e kupton rolin e tij si poet bashkëkohor, pa e vuajtur fare atë dadaizmin e rëndomtë që, siç jemi në dijeni, tenton ta shkatërojë artin e vërtet me shprese që të venë autorin në dukje, qoftë edhe në podiumin e turpit. Me fjalë të tjera, ai nuk ka nevojë të hiqet poet. Ai është poet në poezinë e tij. Ja pesë vargje (të cilat sikur më shtynjë t’i kërkoj ndjesë lexuesit për modestinë pakëz të tepruar të Dibranit):

*Zëri im  
nuk del i bukur as melankolik  
ai kapërthuret ndër dhembë  
bukuria e poezisë gjithmonë mbetet  
në zemër  
pa mundur të kapërcej pragun e kockët (fq. 66).*

Kompozime të tilla dëshmojnë se mendimet e Dibranit nuk janë sipërfaqësore, ato janë gjithmonë komponentë në ndihmë të së vërtetës. Këtu e vërteta qëndron jo vetëm në kualitetin e poezisë së tij aktuale, por edhe në kërkesat që ai ka ndaj vetes si poet. Poezia e tij mbanë në vetvete një gravitet të mençur që na hap një horizont të ri mundësisht për ta shijuar poezinë me të gjitha pikëpamjet që ofron.

Me këtë në mendje mund të themi se principi me të cilin shkruan Dibrani, ka diçka të zbatueshme nga filozofia e piktorit të madh Degas, i cili thoshte (citim i lirshëm i imi) se nuk piktoronte të shfaqte para nesh >>

<< gjërat që shihet, por gjërat që do na bënin ne të shohim ato që ai kishte parë aq thellësisht.

Kjo qëndron sidomos për ato poezi të këtij libri që flasin me "zë të ulët". Ato janë produkt i një imagjinatë aktive që së bashku me shtrësat filozofike e përgatitshin lexuesin për një komunikim me efektive me vargjet:

*Në kodër të rrëpintë  
Drunjtë me degë lëvarura  
Me gunga të stërkalura  
Hije të rënda e gjethe të bruzta  
Gjithçka e ngrysur në piptha këmbësh  
Se kush më parë do ta përqafojë  
hënën (fq. 33)*

Apo, bile edhe më të këtitilla, katër vargjet e para të poezisë filozofike titulluar "Në ndihmë të Jesusit":

*Në një dru të thatë pushë  
Të gozhuar Jezuin  
Dhe një tjetër me gunë të zezë  
Që drurit donte t'i kallte zjarrin  
(fq. 65)*

Këtu prezantohemi tek disa prej poezive të librit "Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër" që jepen kaq solide në mendim, e janë të ndërtaura me kaq mjeshtri sa që idetë dhe shqetësimet sintetizohen aq këndshëm me imazhet e përditshme, me sekretet dhe befasitë e tyre jetësore. Natyrisht në qendër të tyre duket qartë poeti që është i gatshëm t'i hapë dyert e shpirtit dhe të mendjes, që në të ndjekim në komfort të plotë me pasuritë ideore që marrin jetë në vargjet që ai shkruan për ne. Si të këtitilla, vargjet e tij sikur zgjatën të prekin mirësitë njerëzore dhe përktehen në vlera specifike humane.

Në këtë vazhde, krahasuar me librat e mëparshëm tij, "Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër" është dëshmi e një modernizimi më të avancuar në poezinë e Dibranit. Po kaq i rëndësishëm është edhe fakti që ai e ka hedhur këtë hap përpara pa hequr dorë nga mozaiku lirik dhe sensual i niveleve ideore brenda vargut, një fenomen ky, që tashmë është bërë firmë e rritjes së tij si poet. Kjo bën që metafizika dhe lirizmi t'i shërbejnë njëra tjetrës pa e rënduar vargun:

*Ndërsa në anën tjetër të pasqyrës  
Dhe të njeriut shikon fytyra të deformuara  
Jo tonat dhe tonat (fq. 75)*

Ngaqë ra fjala për fytyra, për të reaguar ndaj të "pabesëve" siç i quan ai, poeti i manipulon temat mitike dhe segmentet shpirtë të saj, që në punën e tij janë të pavarura sidomos në kuptimin organik të fjalës. Pra mundësia e rritjes së vibracionit të brendshëm të shqetësimit nuk ndërhyjnë, e lë të lirë atë strukturë amorfe që gjendet aty. Për ta ilustruar këtë mendim pasionat e plotë poezia "Hienat":



Libri i Shefqet Dibranit

*Më ndoqën gjithnjë në agun mënjësor  
Dhe në muzgun e vonë  
Sepse nuk urreja askënd*

*Më ndoqën edhe nëpër dritë të diellit  
Edhe nëpër syrin tënd  
Sepse askujt nuk ia bëra gjëmën  
(fq. 81)*

Dy strofa këto, që janë pjesë e shqetësimit të poetit ndaj etikës së njerëzve, ndaj asaj pjese të shoqërisë që Balzaku i quante souris. Këtë temë Dibrani e trajton në një nivel poetik të sofistikuar. Ai sjell në varg përvojën me ata njerëz që ose e kanë zhgënjyer atë ose të tjerët. Kjo është një nga pikat ku heshtja zien në vetvete në shpirtin e poetit. Është një reagim human në mbrojtje të aspekteve fizike dhe shpirtërore të dashurisë njerëzore. Dibrani e shfaq atë në varg, pa e ndërretë nevojshme shtytjen e mendimeve drejt spiraleve tradicionale të hermetizimit. Kjo, natyrisht, nuk duhet të ketë qenë e lehtë për të. Por e gjithë poezia e librit tregon se ai ka mundur të gjejë një këndvështrim nga ku, njëherësh me ndjenjën e dashamirësisë ndaj të tjerëve, të hapë gjerësinë e madhe shpirtërore—dhe të vë në jetë disa nga cilësitë më të veçanta që gëzojnë rritjen si poet, vetëdijjen aktive dhe identifikimin e vetvetes në kërkim të paqes njerëzore. Pikërisht me paqen në mendje ai na sugjeron:

*Mos harroni një gur të errët  
Ku të shkruhet testamenti i bardhë  
(fq. 30)*

Përkthyer në gjuhën e popullit, këto dy vargje janë një mësim që na kujton të mos harrojmë se të gjithë do të vdesim një ditë. Trajtimi që Dibrani i bën vdekjes në "Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër" është delikat dhe me zë të "ulët". Këtë ai e vë në jetë jo vetëm duke vënë shpirtin mbi gjykimin dhe gjykimin mbi aspektet kapriçozë të jetës, por edhe duke përdorur një metodë apo strategji gjuhësore efektive. Esenca e argumentit këtu nuk ka të bëjë vetëm me përdorimin racional dhe ekonomik të tonit gjuhësor në poezinë e tij, por dhe me kondensimin e ritmit të brendshëm të vargut, me atë shfaqjen efektive të përdorimit të njëjësive të zgjedhura gjuhësore dhe aplikimin në vendin dhe kohën e duhur të tyre. Ky manovrim autorial shërben si lehtësim në ritëm dhe si zbulim në mendimet e tij për subjektin që trajton.

Së fundi, nga e gjithë poetika e jo-rëndomtë e Shefqet Dibranit, për mendimin tim, "Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër" është libri poetik më i arrirë. Toni human i punës së tij në këtë libër rrezaton mbi hapësira të reja shprehje, mbi thellësi më të mella mendimi, mbi burime më të pastra ndjenjash, mbi formulime më artistike të strukturës dhe mbi pastërti më të dukshme të vargjeve në tërësi. Këtë nuk mund ta thonë të gjithë poetët. Ai ka pritur shtatë vjet nga libri i tij i mëparshëm me poezi, një pritje që ka rezultuar në të mirë të letërsisë shqipe, në të mirë të lexuesve të tij, në të mirë kohës në të cilën jetojmë, dhe në të mirë të tij si poet.

## "Nostalgjia e filmit të huaj"

Shfaqen nga 10-13 mars 2008

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Bashkinë Pogradec do të organizojnë në qytetin liqenor "Nostalgjinë e filmit të huaj", nga data 10-13 mars 2008, në kinemanë e Pallatit të Kulturës "Lasgush Poradeci". Aktiviteti do të ketë përmasa të gjera, pasi do të prezantojë në katër ditë prodhimet më të mira kinematografike të shek. XX, që kanë lënë mbresa, nostalgji dhe i kanë rezistuar kohës, të adhuruar për shikuesin e këtij qyteti të vogël buzë liqenit të Ohrit. Aktiviteti do të zhvillohet në katër ditë, ku do të ketë prezantime dhe ditë të veçanta për filmin francez, italian, amerikan dhe atë rus. Qëllimi kryesor është evidentimi i vlerave më të mira kinematografike të filmave prodhime perëndimore, të cilat në kohën e regjimit komunist ishin një oaz i mirë shpirtëror, një dritare nga ku spektatori shqiptar shikonte botën e ëndërruar. Njëherësh janë përzgjedhur filma që kanë karakter edukues, informues, vlera artistike dhe historike. Aktiviteti do të jetë falas dhe për një publik të gjerë, masiv, jo vetëm, nostalgjik, por edhe të rinj, nxënës shkollash, të cilët do të përfitojnë nga ato krijime kryevepra të kinemasë botërore të cilat i kanë rezistuar kohës. Për të gjallëruar sa më shumë jetën kulturore e artistike në këtë qytet, pritet që aktiviteti të ketë edhe pjesëmarrje e përfaqësues të huaj, të cilët do të flasin në përgjithësi për vlerat dhe rëndësinë e këtyre filmave, aktivitetet ndërkombëtare që priten të jenë në vendin tonë e kryesisht në këtë qytet.

### 10 mars 2008 - Dita e Filmit Francez

#### Ora 11.00

« Babeta shkon në luftë » (Babette s'en va a la guerre), 1959, 90 min

Regjia: Christian Jaque. Me Brigitte Bardot, Jacques Charrier, Ronald Howard

#### Ora 17.00

« Metamorfoza e një qyteti », imazhe të Pogradecit në vite « Një mungesë aq e gjatë » (Une aussi langue absence), 1960, 92 min

Regjia: Robert Porte. Me Alida Valli, Georges Wilson, Amedeo Paul Faivre

### 11 mars 2008 – Dita e Filmit Italian

#### Ora 11.00

« Ditë dashurie » (Giori d'amore), 1954, 85 min  
Regjia: Giuseppe de Santis. Me Marcello Mastroiani, Marina Vlady, Angelina Longobardi

#### 17.00

« Nositi », film dokumentar shqiptar, 1989, 19 min  
Regjia: Edmond Topi, Një film për Lasgush Poradecin  
« Më fal » (Perdonami), 1952, 70 min  
Regjia: Carlo Costa. Me Raf Vallone, Antonella Lualdi, Tamara Less, Aldo Bufi - Landi

### 12 mars 2008 – Dita e Filmit Amerikan

#### Ora 11.00

« Rroftë Zapada » (Viva Zapada), 1952, 100 min  
Regjia: Elia Kazan. Me Marlon Brandon, Jean Peters, Anthony Quinn

#### Ora 17.00

« Metamorfoza e një qyteti », imazhe të Pogradecit në vite « Perënditë me kokë poshtë », 1980, 110 min  
Regjia: Jamie Uys. Me Marius Wers, Sandra Prinslee, Nixau

### 13 mars 2008 – Dita e Filmit Rus

#### Ora 11.00

« Zonja me kone », 1959, 86 min  
Regjia: Josif Krefits. Me Aleks Batallov, Iva Savvina

#### Ora 17.00

« Metamorfoza e një qyteti », imazhe të Pogradecit në vite « Ballada e ushtarit », 1959, 86 min  
Regjia: G. Cuhraj. Me Vollandia Ivashev, A. Maksimova, Zhana Prohorenko